

**REGJISTRI NDËRMARRJEVE**

www.registroimpresa.it

NR.PRA/58437/2013 CBAAUTO



BARI, 20/06/2013

RICEVUTA ME PARAQITJEN E MARË NË RRUGË TELEMATIKE NË ZYRËN E  
REGJISTRIMIT TË NDËRMARRJEVE NË BARI  
TË AKTEVE TË MËPOSHTME E KËRKESAVE:

LIDHUR ME SHOQËRINË:  
TECNOSYSTEM ENGINEERING S.T.L.

FORMA JURIDIKE:SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA  
KODI FISKAL DHE NUMRI I REGJISTRIMIT:04324920729  
E REGJISTRIT TË NDËRMARRJEVE NË BARI

E REGJISTRUAR NË SEKSIONIN E ZAKONSHËM  
NUMRI I REPERTORIT EKONOMIK ADMINISTRATIV:324305

LISTA E AKTEVE TË PARAQITURA:

- 1) A05 NDRYSHIMI I AKTIT TË THEMELIMIT( SOC ME KAPITALE E COOPERATIVE  
DT . AKTIT:04/06/2013

LISTA E MODELEVE TË PARAQITURA:

C1		NJOFTIMI I VETËM I PARAQITUR PËR QËLLIME R.I.
S2	RIQ 13	ORGANET E SHOQËRISË DHE FUNKSIONET
S2	RIQ 14	FUQI TË REJA ADMINISTRIMI E PËRFAQËSIMI,ORGANET NË DETYRË
S2	RIQ 18	OBJEKTI I RI I SHOQËRISË
S2	RIQ 20	NDRYSHIME TË REJA STATUTORE-AKTE E FAKTE SUBJEKTE ME DEPOZITIME.
S2	RIQ A	NDRYSHIMI NË SHOQËRI KONSORCIUM,G.E.I.E. ENTI PUBLIK ECON.

DATA KËRKESËS: 20/06/2013

DATA E PROTOKOLLIT;20/06/2013

TAKSAT		**90,00**	ARKA AUTOMATIKE
TOTALI	Euro	**90,00**	
Pagesa e Kryer në Ruro***			

Adresa e Referimit: STSNLS81A53L109N- ANNALISA-VIA NAZAR

FIRMA E NËNPUNËSIT  
PROTOKOLLI AUTOMATIK

KJO RICEVUTË VËRTETON NË MËNYRË EKSKLUZIVE PARAQITJEN E MARË TË MODELIT TË  
KËRKESËS OSE DHE TË DEKLARIMIT.  
RREGULLSIA E DOKUMENTACIONIT TË PARAQITUR DO TË PROVOHET NGA FUTJA NË  
REGJISTRIN E NDËRMARRJEVE OSE /DHE NË R.E.A. TË TË DHËNAVE TË KOMUNIKUARA.

Data e ora e protokollit:20/06/2013 10:42:53

Data dhe ora e stampimit të kësaj ricevute:20/06/2013 12:19:44





Zyra e Regjistrimit të Ndërmarrjeve në Bari

Registroidmprese  
Ricevutë Komunikimi

Printuar më: 20/06/2013 12:20:08

## RICEVUTË PRANIMI E KOMUNIKIMIT TË VETËM

Ky dokument përbën titull për dërgimin e menjëhershëm të aktivitetit sipërmarrfës(1) dhe njoftimit të fillimit të procedimit

Numuri protokollit:RI/PRA/2013/58437  
Kodi Praktikës:613r4551(2)

Data e protokollit: 20/06/2013  
Data e pranimit të njoftimit”20/06/2013

### TË DHËNAT ANAGRAFIKE TË SHOQËRISË

Emërtimi:TECNOSYSTEM ENGINEERING S.R.L.

Krahina selia;BARI

Kodi Fiskal:04324920729

TVSH:04790250726

Numri REA(4) :324305

### LËNDA E KOMUNIKIMIT

Plotësime:NDRYSHIME

Enti pritës:

Me numrin e protokollit (2) Data e kalimit

**REGJISTRI NDËRMARRJEVE RI/PRA/2013/58437/800**

### EKSTREME TË DEKLARUARA

Deklaruesja: ANNALISA STASI

Kodi Fiskal:STSNLS81A53L109N

Adresa e-mail/PEC :annalisa.stasi@postacertificata.notariato.it

Telefoni: 0809759081

Vendndodhja elektronike e Shoqëriosë:TECNOSYSTEMENGINEERING@PEC.IT

### LISTA E DISTINTAVE INFORMATIKE TË PRANISHME NË KOMUNIKIM

Emri file të bashkangjitur  
613R4551.CUI.PDF.P7M

Enti pritës  
REGJISTRI NDËRMARRJEVE

PËRGJEGJËSI I PROCEDIMIT





Regjistruar në Bari më 13 qershor 2013 me numrin 15982/IT

Numri 123 Repertori

Numur 102 Koli

PROÇES VERBAL VENDIMI ASAMBLEJE  
REPUBLIKA ITALIANE

Më datë 4 qershor dymijë e trembëdhjetë(4/06/2013), në orën nëntëmbëdhjetë e pesëdhjetë minuta

Në Modugno, në Zonjën Industriale, Via delle Violette nr. 12, u kërkua

Para meje Avokate Annalisa STASI, Notere me rezidencë në Rutigliano, e regjistruar në Dhomën Noteriale të Bashkuar në Bari, u paraqit Zoti:

Giovanni DEGENNARO , i lindur në Bitonto më 30 tetor 1945 dhe me banim për detyrën që mbulon pranë shoqërisë, i cili deklaroi se merr pjesë në këtë akt, në cilësinë e Kryetarit të Këshillit Administrativ dhe Administratorit Ligjor, përfaqësues i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuara "TECNOSYSTEM ENGINEERING" S.R.L; me seli në Bari në Via Devitofrancesco nr.31/C, kapitali i shoqërisë 102,258,46 Euro,tërësisht i derdhur, e regjistruar në Regjistrin e Shoqërive me numrin e kodin fiskal: 04324920729, 04790250726,R.EA.,numri 324305.

Uuë Noteri jam i sigurtë për identitetin personal, i cili më ka deklaruar se u mblodh këtu në formë totalitare, asambleja e ortakëve të shoqërisë së mësipërme "TECNOSYSTEM ENGINEERING" Srl, për të diskutuar dhe vendosur sa poshtë vijon, fillimisht e dakortësuar nga të pranishmit:

RENDI I DITËS

1-Zëvendësimin integral të Statutit të shoqërisë edhe për përshtatjen e disiplinës së re të shoqërisë me kapital sipas Dekretit Legjislativ 17 janarit 2003,nr.6 e vijues e ndryshimeve dhe plotësimeve, si dhe të Dekretit Legjislativ 9 shkurt 2012,nr.5 e konvertuara me ndryshime në Lijin 4 prill 2012 nr.35, dhe ndryshimeve të tjera e funksionale për përshtatjen, midis të cilave:mënjanimin e adresës së selisë së shoqërisë,objektit të shoqërisë,asamblesë, me mundësinë midis të tjerave të përdorimit edhe të sistemit të lidhjes audio/video,shumicës, sistemit të administrimit, kontrollit kontabël, klauzolës së prishjes së shoqërisë,ndryshimeve të ndryshme edhe të koordinimit.

2-Vendime

Pala e porositur, në cilësinë e tj, më ka kërkuar që të marri në formë publike proces-verbalin e kësaj Asambleje,duke shtuar unë Noteri sa poshtë vijon:





Merr kryesimin e mbledhjes së asamblesë, në bazë të Statutit të Shoqërisë, i Përfaqësuari Zoti Giovanni DEGENNARO, i cili pranon, konstaton dhe bën konstatimin:

se janë të pranishëm ortakët:

-shoqëria LATER.FIN S.R.L. , me seli në Bari në Via Melo nr.229, kapitali I shoqërisë 312.000,00 Euro, tërësisht I derdhur, e regjistruar në Regjistrin e Shoqërive në Bari me numrin, kodin fiskal dhe TVSH 04786520728, .R.E.A.numri 334237, këtu e përfaqësuar nga Këshilltari Zoti Canio SCIANATICO, i lindur në Bari më 21 gusht 1963,, mbajtëse e një kuote me vlerë nominale 51.129,23 Euro, baras me 50% të kapitalit të shoqërisë,

-Shoqëria DGE HOLDING S.R.L., me seli në Modugno në Zonën Industriale via Delle Violette nr.12, kapitali I shoqërisë 103.301.764 Euro, e regjistruar në Regjistrin e Shoqërive në Bari me numrin, kodin fiskal dhe Tvsh 06366790720, R.E.A numri 553599, këtu e përfaqësuar nga Kryetari I Këshillit Administrativ Zoti Giovanni DEGENNARO, i lindur në Bitonto më 30 tetor 1945, mbajtëse e kuotës me vlerë nominale në Euro 51.129,23, baras me 50% e kapitalit të shoqërisë.

-merr pjesë gjithë Organi Administrativ e përfaqësuar nga personi në fjalë, Kryetari i Këshillit Administrativ, dhe nga Zoti Canio SCIANATICO, Këshilltar,

- që ka marrë përsipër, në bazë dhe në zbatim të nenit 2371 të kodit civil, që sigurohet nga identiteti dhe legjitimitimi i të pranishmëve.

- se të gjithë pjesëmarrësit deklarojnë së janë të informuar në mënyrë të mjaftueshme për argumentat e vendosura në rendin e ditës dhe se nuk kundërshtojnë diskutimin e tyre;

- se prania e asamblesë është rregullisht e mbledhur në formë totalitare dhe për këtë është në gjëndje që të diskutojë e të vendosi për rendin e ditës

Mori fjalën Kryetari, i cili e deklaroi të hapur mbledhjen.

Duke trajtuar pikën e parë të rendit të ditës, Kryetari i Këshillit Administrativ i propozon Asmablesë përshtatjen e një Statuti të ri të shoqërisë, që lejon që të përshtasi strukturën e shoqërisë në realitetin e sotëm tregtar dhe ekonomik si dhe normativat e reja sipas Dekretit Legjislativ, si dhe të Dekret Ligjit 9 shkurt 2012, nr.5, e konvertuar me ndryshimet e ligjit 4 prillit 2012, nr.35, i pasqyron shkurtimisht ndryshimet që duhen kryer, midis të tjerave sidomos atë të ndryshimit të adresës të selisë së shoqërisë, të objektit të shoqërisë, asamblesë, me mundësinë midis të tjerave të përdorimit edhe të sistemit të administrimit, kontrollit kontabël, për futjen e klauzolave për prishjen e shoqërisë dhe ndryshimeve të ndryshme edhe të koordinimit.

Kryetari bëri leximin e tekstit të ri të Statutit të Shoqërisë, që përbëhet nga tridhjetë nene, i bashkangjitet këtij akti me gërmën "A", për tu bërë pjesë plotësuese dhe thelbësore.

Në këtë mënyrë, pasi u ezaurua relacioni, Kryetari fton Asamblenë që të vendosi >





Pas diskutimesh të shumta, asambleja, me mendimin pro të të gjithë ortakëve, e shprehur me ngritjen e dorës, Kryetari më deklaroi se

**VENDOSI-**

1) Të miratojë, nen për nen, Statutin që do të mbajë shoqëria, me qëllim përshtatjen e strukturës së shoqërisë në realitetin e sotëm tregtar dhe ekonomik si dhe normativat e reja sipas Dekretit Legjislativ, si dhe të Dekret Ligjit 9 shkurt 2012, nr.5, e konvertuar me ndryshimet e ligjit 4 prillit 2012, nr.35, i pasqyron shkurtimisht ndryshimet që duhen kryer, midis të tjerave sidomos atë të ndryshimit të adresës të selisë së shoqërisë, të objektit të shoqërisë, asamblesë, me mundësinë midis të tjerave të përdorimit edhe të sistemit të administrimit, kontrollit kontabël, për futjen e klauzolave për prishjen e shoqërisë dhe ndryshimeve të ndryshme edhe të koordinimit,

ky statut ju bashkangjit proces-verbalit me germën "A" për krijimin e pjesës integruese dhe thelbësore:

2) Të delegojë Organin Administrativ për kryerjen e të gjitha veprimeve, përmbushjeve dhe formaliteteve të nevojshme ose të dobishme për zbatimin e çfarë është vendosur.

Në këtë mënyrë, duke qenë se nuk asgjë tjetër për të vendosur dhe asnjë nuk ka kërkuar fjalën, Kryetari e deklaroi të mbyllur asamblesën dhe është ora njëzetë e dyzetë e pesë minuta.

Shpenzimet e këtij akti e rrjedues janë në ngarkim të shoqërisë.

Unë Noteri i lexova bashkangjijtjen.

Me kërkesë të palës interesuar, unë Noteri mora këtë akt, ku ja lexova palës së paraqitur të cilën e miraton atë, duke shprehur vullnetin e tij të plotë dhe bashkë me mua noterin e nënshkruaj atë në orën Njëzetë e pesëdhjetë e pesë minuta. Pjesërisht e shkruajtur nga një person i besuar ngas unë dhe pjesërisht e plotësuar nga unë Noteri, e përpiluar në dy fletë, që zë gjashtë faqe, e firmosur dhe faqja e shtatë deri këtu.

Firmosur: Giovanni DEGENNARO-Annalisa STASI Noteri ( është vulosur)

NOTERE  
ANNALISA STASI  
Firma Vula





BASHKANGJITJA "A" me numrin 123/102

**STATUTI  
TITULLI I**

**EMËRTIMI-SELIA-VENDNDIDHJA E ORTAKËVE-KOHËZGJATJA-OBJEKTI**

**NENI 1 EMËRTIMI**

Ne bazë të nenit 2463 të Kodit Civil krijohet një shoqëri me përgjegjësi të kufizuara me emërtimin

**"Tencosystem Enginerring S.,r.l."  
NENI 2-SELIA**

Shoqëria e ka selinë në Komunën e Barit,Krahina e Barit, në Via G.DEVITOFRANCESCO nr.31/C ,kjo me adresën që rezulton nga regjistrimi i ndjekur në Regjistrin e Ndërmarrjeve në bazë të nenit 111-TER të dispozitave në zbatim të Kodit Civil.

Organi Administrativ ka të drejtë që të krijojë e të suprimojë, në Itali e jashtë saj, Filjale, Degë, Zyra, Pika shitje,Përfaqësi,Agjensi ose njësi lokale gjithsesi të caktuara, ose që ta transferojë selinë e shoqërisë në Komunën e sipërpermëndur.

Ndërkaq i takon,ortakëve që të vendosin krijimin e selive dytësore ose transferimin e selisë së shoqërisë në një komunë tjetër ndryshe nga ajo e caktuara më sipër.

Këto vendimet e fundit bëjnë pjesë në kompetencën e asamblesë së ortakëve

**NENI 3-VENDQËNDRIMI I ORTAKËVE**

Vendqëndrimi i ortakëve, për të gjitha marrëdhëniet me shoqërinë, nënkuptohet me të gjitha efektet që rezultojnë në Librin e shoqërisë të ndërmarrjeve kompetente për territorin ose, në alternativë,ajo që rezulton në Regjistrimin Anagrafik të Komunës së Rezidencës të Ortakut.

**NENI 4-KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë është fiksuar deri më 31 dhjetor 2030(dymijë e tridhjetë),vetëm me përjashtim zgjatjeje ose prishje të parakohshme nga Asambleja e Ortakëve.

**NENI 5- OBJEKTI**

Shoqëria ka për objekt:

-A)Dhënien e të gjitha shërbimeve që kanë të bëjnë me projekttime,me llogaritjen e beton armesë dhe me drejtimin e punimeve të ndërtimit, përjashto ushtrimin e aktiviteteve të njëjta gjithsesi



të natyrës profesionale që i rezervohet në bazë të ligjit të dt 23 nëntor 1939, nr.1815 dhe e regjistruar në regjistrat e vecantë;

-B) Të kujdesohet për paraqitjen e projekteve përpara Autoriteteve kompetente si dhe kryerjen e praktikave të nevojshme për marrjen e licencave të ndërtimit e të pasjes me licencë, si dhe me grumbullimin e pasurive të paluajtëshme të ndërtuara, përjashto ushtrimin e aktiviteteve të njëjta gjithësi të natyrës profesionale që rezervohet në bazë të ligjit të dt 23 nëntor 1939, nr.1815 dhe e regjistruar në regjistrat e vecantë;

-C) Kërkime me qëllim shtimin e aktivitetit të shoqërisë, pjesëmarrje të tjera në nismat e saja;

-D) Përbushjen e shërbimeve teknologjikisht të përparuara në përgjithësi, në sektorin e gjeologjisë, të gjeomorfologjisë, të gjeologjisë së aplikuar, të gjeoteknikës, të gjeologjisë marine, të oqeanografisë, studime batimetrike, rymametrike, meteomarine, të valëzimeve, etj, për gjeologjinë sizmike, për gjeologjinë minerale, kalcimentologjinë dhe me artin mineral në përgjithësi; studime komplekse, realizime, menaxhime, shëndoshjen e rikuperimin që ka të bëjë me kërkimin dhe nxjerrjen e mineraleve e materialeve natyrale për ndërtime dhe për përdorime industriale; me ekologjinë në përgjithësi e me aktivitete të cilat lidhen me planifikimin territorial, me projektimin mjedisor dhe atë ekologjik, me eksperimentimin, projektimin, realizimin e menaxhimin e strukturave dhe pasiveve ekologjike në përgjithësi, me monitorimin e të dhënave territoriale e mjedisore; Agrometeorologjinë, projektme, eskperimentime, realizime dhe menaxhime të strukturave dhe menaxhim të rjetit agrometeorologjik, aerofotogrametrinë, telerilevime, fotointerpretimet topografike, hartografinë tematike, pedologjinë, gjeo-pedologjinë, analizën e trojeve, të kompleksit të aktiviteteve të kërkimeve të aplikuara, eksperimentimin, studimin, planifikimin, projektimin, realizimin e menaxhimin e strukturave e veprave të finalizuara me zhvillimin bujqësor të tokës, me studime suportit, laboratore dhe në vend, të çfarëdo lloji vepre inxhinjerie civile e industriale, projektme, realizime dhe menaxhime laboratorësh për analizat dinamike-fizike të tokave, ujrave në përgjithësi si dhe me përcaktimin me anë të provave të cilësisë, treguesve e karaktersitikave fiziko-mekanike të tokës e të shkëmbinjve, me karakteristikat e materialeve të ndërtimit e materialeve të përdorimit, me studime gjeonostike me anë të pasiveve të veta të lëvizsshme, provave në vend, direkt me tokën, rilevimin e kontrollin e parametrave gjeomekaninë e gjeoteknikë me anë të sensorëve, qoftë në tokë e në det; me projektimin e realizimin e punimeve të vecanta të inxhinjerisë civile, shtylla, mikroshtylla, tirantë, seti, paratie, konsolidimin e tokave, galerive, veprave hidraulike, etj;

-E) Kryerje sondazhesh, matjesh, si dhe verifikime tekniko-urbanistike të tokave;

-F) Të kujdesohet për marrëdhëniet publike, si dhe me shpërndarjen e reklamimin e nismave;

-G) Të kujdesohet për tratativat e marrëdhëniet me ndërmarrjet deri në lidhjen e kontratave të sipërmarrjes;



- **H)** Kryerjen e shërbimeve të projektimit, realizimit, mirëmbajtjes, administrimit, ushtrimit e menaxhimit të çfarëdo lloj veprë (mobiljare, imobiljare, ndërtimore dhe hoteleri, industriale, rrugore, hidrike, rjeti kanalizimeve, sportive ,etj), Impjante, paisje, instalime ose shërbime me interes publik ose privat, me përjashtim të ushtrimit të aktiviteteve të njëjta gjithsesi me natyrë profesionale, e rezervuar në bazë të Ligjit dt 23 nëntor 1939, nr.1815 dhe të regjistruara në regjistrat e vecantë;

-**I)** Të blejë e të shesi pasuri rustike e urbane, si dhe sidomos të ndërtojë, me shitjen ose jo, këto të fundit;

-**J)** Të japi konsulencë administrative e tekniko ekonomike lidhur me përpunimin e studimeve, programeve, projekteve, ekspertizave, planeve të fatibilitetit dhe planifikimit për çfarëdo lloji kërkese ose nevoja të ndërmarrjes;

-**K)** Të përpunojë ose të ndjeki projektet e investimit, financimit e kërkesave nxitëse, beneficeve e lehtësimeve të çfarëdo lloj natyre të parashikuara nga normat Europiane;

-**L)** Dhënien e shërbimeve të konsulencës e organizimit që ka të bëjë me problematikat e menaxhimit të ndërmarrjes, të studimit dhe zhvillimit, të logjistikës e shpërndarjes, për marketingun, për publicitetin e futjen tregtare, të aseteve ekonomiko-financiare dhe në organizimit administrativ e kontabël;

-**M)** Me kërkimin e tregut, të japi e të marri licencën e shfrytëzimit tregtar;

Shoqëria, për arritjen e objektit të shoqërisë mund të kryejë të gjitha veprimet tregtare, industriale e imobiljare dhe për për më tepër mund të kryejë, në rrugë prioritare e aksesore dhe instrumentale e gjithsesi me përjashtimin e shprehur të çfarëdo lloj aktiviteti të kryer për publikun, veprime financiare e mobiljare, të japi dorëzani, të japi garanci, të japi hua dhe kreditime edhe hipotekore, të japi garanci për vehte ose/dhe për të tretët, si dhe të marri, vetëm për qëllime investimi të qëndrueshëm e jo sistemimi, qoftë në mënyrë indirekte, ashtu edhe direkte, të marri pjesë në shoqëri italiane e të huaja me të njëjtin objekt aktiviteti, të ngjashëm ose të lidhur me të, në respektim të nenit 2361 të Kodit Civil, pra me përjashtimin të çfarëdo lloj aktiviteti që i rezervohet në bazë të ligjeve nr.1 të dt 2 janar 1991 e nr.197 të dt 5 korrik 1991.

Përjashtohet shprehimisht çfarëdo lloj aktiviteti që bën pjesë në parashikimet që nevojiten për regjistrimin në regjistrat profesionalë e çfarëdo lloj aktiviteti financiar që ndalohet nga ligji në fuqi sipas kohës e sidomos në bazë të nenit 113 të D.Lgs. 01/09/1993, nr. 385.

**TITULLI II**  
**KAPITALI I SHOQËRISË DHE NDRYSHIMET E SAJ-FINANCIMI I ORTAKËVE**  
**TITUJ DEBITI- TË DREJTA TË ORTAKËVE**  
**TRANSFERIMI I KUOTAVE PJESËMARRËSE**  
**E DREJTA E HEQJES DORË-PËRJASHTIMI I ORTAKUT**





## NENI 6- KAPITALI I SHOQËRISË E NDRYSHIMET E SAJ.

Kapitali i shoqërisë është 102.258,46(Njëqintë e dy mijë e dyqintë e pesëdhjetë e tetë,presje dyzetë e gjashtë Euro).

Kapitali i shoqërisë mund të rritet me pagesë(nëpërmjet kontributeve të reja me para ose në natyrë) ose falas(me anë të kalimit të rezervave të disponueshme në kapital) mbi bazën e vendimit të asamblesë së ortakëve që vendosin me shumicën e parashikuar për ndryshimin e statutit.

Kapitali i shoqërisë mund të krijohet edhe me derdhjen e kreditimit, sende në natyrë e në përgjithësi nga cdo cfarëdo lloj elementi tjetër të aktivitetit të ndjeshëm për vlerësimin ekonomik sipas mënyrave të parashikuara në nenin 2464 të Kodit Civil.

Derdhja mund të bëhet me anë të një police siguracioni ose të një dorëzanie bankare me të cilat i garantohet, gjithë vlera për ata të caktuara, detyrimet e marra përsipër nga ortaku me objekt dhënien e shërbimeve në favor të shoqërisë.Në këtë rast polica ose dorezania mund të zëvendësohen nga ortaku me derdhjen, si formë garancie, që korrespondon me vlerë në para në Shoqëri.

Ortakëve i takon e drejta e nënshkrimit të pjesëmarrjeve të dhëna në selinë e rritjes së kapitalit të shoqërisë në përpjestim me përqindjen e kapitalit nga sejcili nga ata në mënyrë respektive e zotëruar në ditën kur firma është vënë,Ortakët gjithsesi vendosin se pjesëmarrjet e dhëna në vendin e rritjes të kapitalit të shoqërisë t'i jepen nënshkruesve në masë jo proporcionale derdhjet në kapitalin e shoqërisë nga vetë ata.

Nënshkrimi i kontributeve të dhëna në selinë e rritjes së kapitalit të shoqërisë mund ti rezervohet si plotësisht ose pjesërisht personave të tretë jashtë shoqërisë, me përjashtimin ose me kufizimin e së drejtës të opsionit e ushtruar nga ortakët e vjetër.Në këtë rast,vendimi i rritjes së kapitalit të shoqërisë duhet të bëhet sipas arsyeve të kufizimit ose të përjashtimit të drejtës me zgjedhje e i takon ortakëve jo dakort e drejta e heqjes dorë sipas nenit 2473 të Kodit Civil.

Në rast mungese derdhje kontributi në afatet e paracaktuara,Organi Administrativ do të zbatojë ashtu sic parashikohet në nenin 2466 të Kodit Civil, me të drejtën që të kalojë në ngarkim të ortakëve me detyrime, mbi kuotën e kapitalit të duhur, interesin vjetor sipas taksës zyrtare referues të rritur të dy pikave,përrjashtojë dëmin e mundshëm shumë të madh.

Vendimi i rritjes së kapitalit nuk mund të zbatohet deri sa derdhjet e mëparshme të detyruara nuk janë kryer në mënyrë integrale.

Kapitali i shoqërisë mund të zvogëlohet në rastet dhe sipas modaliteteve të ligjit(Nenet 2482/BIS,2482/TER e 2482 QUATER të kodit Civil) me anë të vendimit të asamblesë së ortakëve që merret me shumicën që parashikohet me ndryshimin e aktit të themelimit.



Në rast zvogëlimi të kapitalit të shoqërisë në rast humbje, mund të kapërcehet preventivi i depozituar në selinë e shoqërisë, të paktën tetë ditë para asamblesë, të relacionit të Organit Administrativ për gjëndjen pasurore të shoqërisë e të observimeve të Organit të Revizorëve, nëse janë të caktuar, në rastin se konstatohet pëlqimi njëzëri i të gjithë ortakëve. Heqja dorë nga ky depozitim duhet të konfirmohet në selinë e asamblesë e duhet të rezultojë nga proces-verbali.

#### NENI 7-FINANCIMI I ORTAKËVE

Shoqëria ka të drejtë që të mbledhi, edhe pranë ortakëve, fondet e nevojshme për arritjen e objektivit të shoqërisë sipas mënyrave që nuk pengojnë mbledhjen e kursimeve mes publikut në bazë të dispozitave ligjore në fuqi të lëmin bankar e kreditues.

Financimet, edhe ato me të drejtë rikthimin e shumës së derdhur, mund të bëhen nga ortakët për shoqërinë edhe jo në përpjestim të kuotave përkatëse pjesëmarrëse në kapitalin e shoqërisë. Vetëm me përjashtim të vendimeve të marra nga ana e asamblesë së ortakëve, financimet e kryera nga ortakët përgjithmonë do jenë me interes fitimprurës.

Në rast derdhje për llogari kapitali, shpenzimet përkatëse mund të përdoren për mbulimin e humbjeve të mundshme të transferuara me rritjen direkte të kapitalit me çfarëdo lloj vlere e kjo fillimisht me vendimin konform të ortakëve që do merret në asamble.

Për rimborsimin e financimeve të ortakëve, gjen zbatim dispozita e nenit 2467 të Kodit Civil

#### NENI 8-TITUJ DEBITI

Shoqëria mund të japi tituj debitimi mbajtësit ose personave me vendim të ortakëve të marrë me votën pro të ortakëve të cilët përfaqësojnë 2/3 e kapitalit të shoqërisë.

Lëshimi i titullit të debitimit nuk mund të bëhet për një vlerë më të madhe se dyfishi i kapitalit të shoqërisë kështu sic rezulton nga bilanci i fundit të miratuar.

Titujt e debitimit mund të firmosen vetëm nga investitorët profesional subjekte për kujdesin në bazë të ligjeve të vecanta. Në rast qarkullimi të titujve, kush i ka firmosur ato ( e pra qoftë investitori profesional që i ka firmosur ato, është subjekt i së njëjtës kauzë nga subjektet e mësipërm) i përgjigjet aftësisë paguese të shoqërisë kundrejt blerësve që nuk janë investitorë profesionalë ose ortakë të vetë të shoqërisë.

Vendimi i dhënies së titujve duhet të parashikojë kushtet e huasë dhe modalitetet e rimborsimit e duhet të regjistrohet në kujdesin e administratorëve në regjistrin e ndërmarrjeve. Për më tepër, mund të parashikojë që, fillimisht me pëlqimin e shumicës të mbajtësve të titujve, Shoqëria mund të ndryshojë këto kushte e modalitete.



## NENI 9- E DREJTA E ORTAKËVE

Të drejtat në shoqëri i takojnë ortakëve në masë proporcionale me pjesëmarrjen e zotëruar nga secili.

Në rast bashkëpronësie të një kuote pjesëmarrëse, të drejtat e bashkëpronarëve duhet të ushtrohen nga një përfaqësues i përbashkët i caktuar sipas mënyrave të parashikuara nga nenet 1105 e 1106 të Kodit Civil.

Në rast pengu, uzufukti ose sekuestrimi të kuotave pjesëmarrëse zbatohet neni 2352 i Kodit Civil.

## NENI 10-TRANSFERIMI I KUOTAVE PJESËMARRËSE.

Klauzolat e ndodhura në këtë nen nënkuptojnë që të mbrojnë interesat e shoqërisë homogjenitetin e shoqërisë, kohezionin e ortakëve dhe me ekuilibrin e marrëdhënieve midis tyre; për këtë caktohen kufizimet në rastin e transferimit të kuotave pjesëmarrëse të kapitalit

Me "kuota pjesëmarrëse" (ose "marrje pjesë në kuota" nënkuptohet marrja pjesë në kapital që i përket secilit ortak, ose një pjesë e tyre në rast transferimi të pjesshëm, ose/dhe të drejtat e nënshkrimit të tyre.

Me "transferim" nënkuptohet transferimi me akt mes të gjallëve dhe në rast vdekje kuotat pjesëmarrëse ose dhe të drejtave në to.

Me emërtimin "Transferim me akt për të gjallët", nënkuptohen të gjitha negocijimet e tjetërsimit, sipas afatit e pra, veç Shitjes, me titull thjeshtues, jepen kontratat e shkëmbimit, derdhjeve të kontributeve, pagesave, transferimit të mandatit dorëzues dhe dhurimit. Në të gjitha rastet kur natyra e neocjimit nuk parashikon një vlerë ose më mirë vlera është ndryshe nga paraaja, ortakët do të blejnë kuotat pjesëmarrëse duke i derdhur ofertuesit vlerën e përcaktuar me marrëveshje të përbashkët ose, në mungesë mos gjetje marrëveshje, nga një arbitër ose nga Kolegji i arbitrazhit.

Me emërtimin "Transferimi në rast vdekje", nënkuptohen të përfshira trashëgimia legjitime ose testamentare, me titull universal ose të vecantë, me personin fizik ortak.

Emërtimi për Shoqëritë Fiduciare ose Rritullimi, nga ana e saj (fillimisht me paraqitjen e mandatit fiduciar) mbajtësve efektivë, nuk është subjekt ashtu siç parashikon ky nen.

Në rastin e transferimit të kuotave pjesëmarrëse, me akt për të gjallët e kryer pa respektuar sa parashikohet, Blerësi nuk do ketë të drejtë që të regjistrohet në librin e ortakëve, nuk do të legjitimohet me ushtrimin e votës e të drejtave të tjera administrative e nuk mund të tjetërsojë kuotat pjesëmarrëse me efekt drejt shoqërisë.

Kuotat pjesëmarrëse janë lirshëmrisht të pandara e të transferueshme vetëm për:

A)) Ortakët e tjerë;

B) Për bashkëshortin e një ortaku;



C) Familjarëve të radhës parë të një ortaku të cfarëdo lloj radhe;

D) Për Shoqëritë kontrolluese, të kontrolluara të lidhura e gjithësi që i përkasin të njëjtit grup bashkë ortak.

Në cfarëdo lloj rasti transferimi të kuotave pjesëmarrëse, ortakëve rregullisht e regjistruar në regjistrin e ndërmarrjeve I takon e drejta e parablerjes për blerje,

Ortaku i cili ka ndërmend që të transferojë plotësisht ose pjesërisht kuotat e tij pjesëmarrëse një të treti duhet paraprakisht tja ofrojë ortakëve të tjerë, të cilët kanë të drejtë parablerje për blerjen me anë të komunikimit me letër rekomande me të drejtë kthim përgjigje. Në njoftim ortakut duhet të shënojë kushtet e ofertës nga i treti, vecanërisht cmimin dhe mënyrat e pagesave të propozuara nga blerësi potencial.

Ortakët të cilët synojnë që të ushtrojnë të drejtën e parablerjes duhet të informojnë ortakun ofertues me letër rekomande me kthim përgjigje e cila dërgohet brënda 10 ditëve nga marrja e njoftimit.

E drejta e parablerjes nuk mund të ushtrohet pjesërisht e duhet të ushtrohet me të njëjtat kushte të ofruara nga të tretët.

N.se ekziston bashkëpunimi mes shumë kërkuesve, sejçili nga to bën blerjen në masë proporcionale me kuotat pjesëmarrëse në kapitalin e shoqërisë tashma pronë e tij.

Pasi ka kaluar afati i 10 ditëve, pa qenë nevoja se ortakut të ketë bërë me dije vullnetin që të ushtrojë të drejtën e parablerjes, Ortaku mund ta shesë në mënyrë të lirshme kontributin e tij pjesëmarrës vetëm të marrë pëlqimin e organit administrativ, të cilit duhet t'i bëhet me dije identiteti i subjektit potencial blerës me letër rekomande me kthim përgjigje. Refuzimi i mundshëm i pëlqimit, edhe pa arsye, duhet t'i vijë ortakut brënda 30 ditëve nga data e marrjes së komunikimit, N.se, brënda afatit të përmëndur më sipër, asnjë lloj komunikimi kundër nuk i vjen ortakut, pëlqimi do të konsiderohet i dhënë dhe ortakut mund t'a transferojë kontributin pjesëmarrës subjektit të shënuar në njoftim. Sa më sipër e parashikuar zbatohet edhe në rastin e transferimit të pronësisë e të krijimit të pengut e të uzufruktit.

Në rast mos pëlqimi e pra të mos transferimit të kontributit pjesëmarrës në capital, ortakut i takon e drejta e heqjes dorë kështu sic parashikohet nga neni 2469 I kodit civil.

## NENI 11-HEQJA DORË E ORTAKUT

Perveç se në rastet që parashikohen nga ligji, ka të drejtë ortakut që largohet nga shoqëria që nuk ka marrë aprovimin e vendimit lidhur me zgjajtjen e kohëzgjajtjes së shoqërisë ose/dhe futjen ose heqjen e detyrimeve për qarkullimin e kuotave pjesëmarrëse.



Në cdo rast heqje dorë, ortakut duhet të bëjë me dije qëllimin e tij të heqjes dorë me leter rekomande e cila i dërgohet shoqërisë brenda 15 ditëve nga regjistrimi në regjistrin e Ndërmarrjeve vendimi që e legjitimon atë ose, n.se fakti që legjitimon heqjen dorë është ndryshe nga një vendim i asamblesë, brenda 30 ditëve nga marrja dijani e saj nga ana e ortakut.

Ai ka të drejtë që të përfitojë rimborsimin e kuotave të veta pjesëmarrëse në proporcion me pasurinë e shoqërisë. Administratorët duhet të bëjnë vlerësimin duke pasur parasysh vlerën e tregut të shoqërisë, Sidomos duke konsideruar të ardhurat e shoqërisë dhe fillimin e aktivitetit, vlerën e rrjedhshme të mirave materiale e jo materiale nga ato të zotëruar dhe cdo rrethanë e kusht normalisht e konsideruar nga praktika në vlerësimin e kuotave pjesëmarrëse të shoqërisë, e duhet t'i bëjnë me dije ortakut vlerën e propozuar brenda 60 ditëve nga njoftimi i heqjes dorë. Në rast mosmarrëveshje vlerësimi bëhet me kërkesë të palës më të zellshme e gjithë brenda 30 ditëve, me një ekspert të emëruar nga Kryetari i Gjykatës, i cili merr masat edhe për shpenzimet. Rimborsimi i kuotave i pjesëmarrëse për të cilën ushtrohet e drejta e heqjes dorë duhet të bëhet brenda 180 ditëve nga njoftimi i heqjes dorë. Pasi është arritur marrëveshja për vlerën e likuidimit, administratorët duhet të informojnë pa hezitim ortakët e tjerë lidhur me njoftimin për heqje dorë, duke treguar vlerën e likuidimit të dakortësuar e duke fiksuar, për më tepër afatin brenda së cilës ortakët e pyetur duhet të shprehin disponibilitetin e vet që të blejë kuotat pjesëmarrëse të ortakut të dorëhequr. Për më tepër, ortakët mund të gjejnë me marrëveshje një të tretë i vendosur për blerjen. N.s kjo nuk ndodhë, rimborsimi i shpenzimeve bëhet duke përdorur rezervat e disponueshme; në mungesë të këtyre të fundit, ortakët mund të vendosin zvogëlimin proporcional të kapitalit të shoqërisë. N.se, rimborsimi i kuotave pjesëmarrëse të ortakut të dorëhequr gjithësi nuk rezulton e mundur shoqëria vihet në likuidim

## NENI-12-PËRJASHTIMI I ORTAKUT

Mund të përjashtohet ortakut që kryen, në mënyrë individuale ose nëpërmjet pjesëmarrjes në një shoqëri tjetër, aktivitetin konkurrues me atë të shoqërisë ose që është e nënshtruar procedurave. Përjashtimi vendoset nga ortakët me votën pro tëp o aq ortakëve të cilët përfaqësojnë dy të tretat e kapitalit të shoqërisë, duke u përjashtuar nga llogaritja kuotat pjesëmarrëse të ortakut që përjashtohet.

Vendimi, i motivuar si duhet, duhet t'i komunikohet pa hezitim ortakut të përjashtuar nga administratorët.

Përjashtimi ka efekt 30 ditë nga marrja e njoftimit për përjashtim; brenda këtij afati kohor ortakut ka të drejtë që të paraqesi kundërshtimin në gjykatë.

Ortakut i përjashtuar ka të drejtë që të marrë rimborsimin e kuotave të tij pjesëmarrëse, në proporcion me pasurinë e shoqërisë. Për vlerësimin e kuotave pjesëmarrëse dhe rimborsimin e tyre



aplikohen dispozitat që ndodhen në këtë statut. Nuk do jetë e mundur që të procedohet për zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë, as vihet në likuidim shoqëria.

TITULLI III  
VENDIMET E ORTAKËVE  
NENI 13-KOMPETENCAT E ORTAKËVE

Janë kompetencë e ortakëve lëndët e mëposhtme:

- A) Miratimi i bilancit dhe shpërndarja e fitimeve;
- B) Emërimi i Administratorëve;
- C) Emërimi, në rastet e parashikuara nga neni 2477 i kodit civil, të organit të revizorëve ose të revizorit;
- D) Ndryshimet e Aktit të Themelimit;
- E) Vendimi i kryerjes së operacioneve që sjellin një ndryshim thelbësor të objektit të shoqërisë të përcaktuar në aktin e themelimit ose të një ndryshimi të rëndësishëm të drejtave të ortakëve;

Gjithsesi është kompetencë e ortakëve vendimet që një ose shumë administrator ose po aq ortakë të cilët përfaqësojnë të paktën një të tretën e kapitalit të shoqërisë, i nënshtrohet miratimit të tyre.

Gjithsesi është i nevojshëm vendimi i asamblesë kur e kërkojnë një ose shumë administrator ose një numur ortakësh të cilët përfaqësojnë një të tretën e kapitalit të shoqërisë.

NENI 14-PËLQIMI I DHËNË ME SHKRIM

N,se zbatohet metoda e pëlqimit të dhënë me shkrim, sejcili ortak shpreh pëlqimin e tij në një datë të propozuar, e formuluar nga një ortak ose/dhe nga organi administrativ, me anë të njoftimit me shkrim me firmosjen në origjinal ose në mënyrë digjitale, me kujdesin e Organit Administrativ.

Propozimi, me shkrim që i dërgohet shoqërisë me firmosjen në origjinal ose me mënyrë digjitale, duhet t'i përcillet të gjithë ortakëve (dhe për dijeni Administratorëve, organit të revizorëve dhe revizorit kontabël, n,se janë të zgjedhur) me çfarëdo lloj mjeti komunikimi, përfshi postën elektronike, e duhet të përmbajë objektin dhe motivet e vendimit që do merret.

Ortaku i pyetur shpreh votën e tij brënda afatit të fiksuar në këtë propozim ose, në mungesë, brënda 7 ditëve nga marrja e propozimit. Mos deklarimi i ortakut është ekuivalent me votën kundër. Propozimi nënkuptohet i miratuar me votën pro të ortakëve, të cilët përfaqësojnë të paktën më shumë se gjysma e kapitalit të shoqërisë.

Administratori i Vetëm ose Kryetari i Këshillit Administrativ verifikon n,se janë pyetur të gjithë ortakët dhe kryen llogaritjen e votave të shprehura. N,se propozimi bëhet, vendimi duhet t'i bëhet me dije, me çfarëdo lloj mjeti njoftimi të gjithë ortakëve, administratorëve, organit të revizorëve dhe



revizorit kontabël,n.se janë të zgjedhur, dhe duhet të transkriptohet menjëherë në librin e vendimeve, identitetin e votuesve.Të gjitha njoftimet sipas këtij neni mund të bëhen me çfarëdo lloj mjeti komunikimi,përfshi faksin e postën elektronike, që lejon verifikimin e dërgimit dhe të marrjes.Dokumentacioni përkatës do të mbahet e bashkangjitur në librin e vendimeve të ortakëve.

## NENI 15-FUNKSIONIMI I ASAMBLESË

Asambleja thirret nga Këshilli Administrativ,nga Administratori i Vetëm ,ose nga një Administator në selinë e shoqërisë ose gjetkë,edhe pse jo në Itali ose në një prej vendeve që janë pjesë e BE.

Thirrja e asamblesë bëhet me letër rekomande A.R. që dërgohet të paktën tetë ditë përpara asaj të fuksuar për mbledhje.Njoftimi duhet të përmbajë në rendin e ditës, datën e vendin e mbajtjes së asamblesë.

Thirrja e asamblesë mund ntë bëhet nëpërmjet telegramit,Faksit,ose E-mail të konfirmuar nga marrësi(edhe me të njëjtin mjet).

Ortakët, për qëllime të marrëdhënieve të tyre me shoqërinë, zgjedhin vendndodhje në vend,në numrin e përdoruesit të faksit dhe në adresën e postës elektronike të njoftuar,me kohën, në shoqëri;Ortaku që nuk dëshiron të shënojë një numur telefoni,faksi ose një adresë të postës elektronike ose që do të revokojë atë të mëparshmin ka të drejtë që të marrë njoftim në forma të tjera të parashikuara nga statuti.

Aty ku thirrja e asamblesë bëhet me rrugë elektronike,Kryetari i Këshillit Administrativ do të verifikojë marrjen e ndodhur të njoftimit nga ana e të gjithë ortakëve mbi bazën e një liste të posacme të vënë në dispozicion nga furnitorë të hyrjes në internet(provider).

Asambleja gjithsesi është e vlefshme,pavarësisht formaliteteve të mësipërme,n.se përfaësohet nga gjithë kapitali shoqërisë,janë të pranishëm ose/dhe të informuar të gjithë administratorët dhe organi i revizorëve,n.se janë të emëruar,dhe asnjë nuk kundërshton diskutimin.

Marrja pjesë në asamble mund të bëhet edhe me lidhjen me audio ose video konferencë duke respektuar parimet e nenit 19,paragrafi nëntë i këtij statuti.

I takon Kryetarit të Asamblesë që të verifikojë të drejtë për të marrë pjesë në asamble.

Administratorët ose revizorët jo pjesëmarrës duhet të lëshojnë deklaratë të posacme me shkrim me të cilën vërtetojnë se janë të informuar për të gjitha argumentat e vendosura në rendin e ditës dhe se nuk kanë kundërshtime në trajtimin e tyre.

Asambleja është rregullisht e thirrur me praninë e po aq ortakëve të cilët përfaqësojnë të paktën gjysmën e kapitalit të shoqërisë e vendos me shumicën absolute të pranishmëve, dhe, sipas rasteve që



parashikohen nga pikat 4) e 5) të paragrafit të dytë të nenit 2479 të kodit civil, me votën pro të ortakëve që përfaqësojnë të paktën gjysmën e kapitalit të shoqërisë.

Asambleja kryesohet nga Administratori i Vetëm, nga Administratori që ka thirrur asamblenë ose nga Kryetari i Këshillit Administrativ ose, në mungesë të tij, nga një zv/Kryetar ose nga Administratori i Deleguar, n.se janë të emëruar.

Kryetari ndihmohet nga një sekretar i emëruar nga Asambleja me propozim të Kryetarit.

Votimet e Asamblesë bëhen me apelimin nominal ose me ngritjen e dorës.

